



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

Nr. 206P Prot.

Kukës me, 24 . 6 .2019

## KALLZIM - PENAL

**KALLZUESI:** Bashkia Kukes, perfaqesuar nga Kryetari i saj z.Bashkim Shehu  
Adresa "Sheshi Skenderbej" Lagjia Nr.5 - Kukes, Nr. tel. (024) 225-110

**OBJEKTI:** Fillimin e procedimit penal ndaj antareve te KZAZ Nr.11, për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit te detyrës", të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.7905 date 21.03.1995 "Kodi i Procedures Penale" (i ndryshuar) neni 281,249, ligji Nr.7895, date 27.01.1995 "Kodi Penal i RSH-se" (i ndryshuar) neni 248, Dekreti i Presidentit te Republikes te Shqiperise Nr.11199, date 10.06.2019, ligji Nr.8744, date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (i ndryshuar) neni 3/b si dhe VKM Nr.167, date 10.03.2010 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te bashkise Kukes, te Qarkut te Kukesit", (i ndryshuar),

## PERPARA PROKURORISE PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KUKES

### I.Fakte dhe te dhena mbi ngjarjen:

Ne baze te ligjit Nr.8744, date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (i ndryshuar) neni 3/b si dhe VKM Nr.167, date 10.03.2010 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te bashkise Kukes, te Qarkut te Kukesit", (i ndryshuar), objekti i Shkolles se Mesme te Pergjithshme "Havzi Nela" se bashku me te gjithë anekset e tij ku perfshihet dhe palestra sportive i kane kaluar ne pronesi Bashkise Kukes.

Ne zbatim te Dekretit te Presidentit te Republikes te Shqiperise Nr.11199, date 10.06.2019 “Per shfuqizimin e Dekretit Nr.10298, date 05.11.2018 te Presidentit te Republikes “Per caktimin e dates se zgjedhjeve per organet e qeverisjes vendore”, siç jeni ne dijeni nepermjet ketij dekreti u anulua data **30 Qershor 2019** si dite e zhvillimit te zgjedhjeve per organet e veteqeverisjes vendore.

Bashkia Kukës si njesi e veteqeverisjes vendore, me shkresen Nr.1968 Prot. date 14.06.2019, i ka kerkuar KZAZ-se Nr.11,

*Lirimin e menjehershëm te ambienteve te KZAZ Nr.11, prane Qendres Kulturore “Hasan Prishtina” si dhe te palestres sportive te Shkolles se Mesme te Pergjithshme “Havzi Nela” – Kukës.*

Nga ana e KZAZ-se Nr.11, u lirua vetem ambienti prane Qendres Kulturore “Hasan Prishtina”, ndersa palestra sportive prane Shkolles se Mesme te Pergjithshme “Havzi Nela” vazhdonte te mbetej e bllokuar ne kundershtrim me ligjin.

Per shkak te mos marrjes ne konsiderate te kerkeses te dates 14.06.2019, me shkresen Nr.1968/1 Prot. date 18.06.2019 i kemi kerkuar KZAZ Nr.11, qe brenda dates 19.06.2019, ora 11.<sup>00</sup> te lirohej ne menyre te menjehershme palestra sportive e Shkolles se Mesme te Pergjithshme “Havzi Nela” – Kukës.

Me date 19.06.2011, ora 11.<sup>00</sup>, perfaqesuesit e Bashkise Kukës jane paraqitur prane objektit te palestres sportive te Shkolles se Mesme te Pergjithshme “Havzi Nela” per lirimin dhe marrjen ne dorezim te objektit.

Nga ana e perfaqesuesve te KZAZ Nr.11, nuk eshte bere lirimi i ambientit, duke e mbajtur forcerisht ate, me mbeshtetjen dhe te forcave te Policise se Shtetit.

Gjithashtu ju informojme se me shkresen Nr.1997 Prot. date 18.06.2019, kemi kerkuar prezencen dhe mbeshtetjen nga Komisariati i Policise Shtetit per lirimin e ketij ambienti.

Policia e Shtetit ne kundershtrim me misionin e saj per ruajtjen e rendit e të sigurisë si dhe mbrojtjen e prones publike si dhe me parashikimin e nenit 78 te ligjit Nr.108/2014 te miratuar me date 31.07.2014 “Per policine e Shtetit” nuk zbatoi kerkesen e Bashkise Kukës.

Ne kushtet qe pas anulimit te dates se zhvillimit te zgjedhjeve per organet e veteqeverisjes vendore ne baze te Dekretit te Presidentit te Republikes se Shqiperise Nr.11199, date 10.06.2019, nga ana e KZAZ-se Nr.11 mbahet i bllokuar nje objekt ne pronesi te Bashkise Kukës, ky veprim ne kete rast perben element te vepres penale.

Duke vleresuar rastin si mospermbushje e detyrimeve te ngarkuara nga nje akt kushtetues i detyrueshem, i cili ka marre fuqi juridike ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise pas botimit ne Fletoren Zyrtare Nr.84, date 11.06.2019 siç eshte Dekreti i Presidentit te Republikes, me gjithë dijenine per detyrimin dhe ne kundershtrim te hapur me funksionin ligjor, me tagrin dhe pergjegjesine e ngarkuar nga ana e antareve te KZAZ Nr.11, në referim te nenit 281 te Kodit të Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se:

- *“Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve apo të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një veper penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallzim me shkrim .....”* Ju drejtohem duke Ju parashtruar kete kallezim penal.

Ne rastin konkret, mos-dorezimi i objektit ne pronesi te Bashkise Kukës nga ana e KZAZ-se, cenon veprimtarine institucionale dhe marredheniet juridike te vendosura me ligj.

## II. Analiza e elementeve te vepres penale:

Ne vleresimin real te situates, antaret e KZAZ Nr.11-Bashkia Kukes kanë konsumuar ne bashkepunim veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Ne analizen ligjore te veprimit te antareve te KZAZ Nr.11, ju parashtrojme te gjithë elementet e vepres penale lidhur me çështjen e referuar ne kete kallzim penal, si me poshte vijon:

**1.Objekti** i vepres penale te “Shpërdorimit te detyres”, jane marredheniet juridike te vendosura me ligj ose aktet nenligjore, per te siguruar ushtrimin e veprimtarise shteterore dhe te drejtat e ligjshme te shtetit dhe shtetasve, te cilat nga legjislacioni penal, mbrohen posaçerisht nga veprimet dhe mosveprimet e kunderligjshme. Siç argumentuam dhe me siper ky element permbushet plotesisht duke qene se Bashkia Kukes eshte penguar ne ushtrimin e funksioneve te saj te parashikuara ne Kushtetute dhe ne ligjin Nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”.

**2.Elementi i dyte i anes objektive.** Sipas nenit 248 të Kodit Penal, krimi i shpërdorimit te detyres kryhet me veprime aktive te kunderligjshme ose me moskryerjen e veprimeve qe perbejne mosperpushje te rregullt te detyres. Keto jane tipare te domosdoshme te cilat plotesohen me konstatimin e lidhjes shkakesore ndermjet veprimit ose mosveprimit te kunderligjshem dhe demtimit te interesave te shtetit, shtetasve apo personave te tjere juridik.

**3.Subjekti** i vepres penale te shpërdorimit te detyres eshte nje subjekt i posaçem. Personi/at te cilat po kallzohen penalisht jane funksionare publike te pajisur me tagra pushteti, te cilet duhet te ushtrojne veprimtarine shteterore ne perputhje te plote me Kushtetuten dhe legjislacionin ne fuqi. Jane ekzaktesisht keto cilesi te posaçme te cilat jane perdorur (keqperdorur), nga keto persona per kryerjen e vepres penale te shpërdorimit te detyres duke vepruar ne kundërshtim me ligjin per permbushjen e detyrave funksionale.

**4.Element tjetër i kesaj vepre penale eshte elementi i anes subjektive.** Referuar nenit 248 te Kodit Penal krimi i shpërdorimit te detyres nenkupton, kryerjen **me dashje** te veprimeve ose mosveprime në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe personave të tjerë juridikë.

## III.Analiza Ligjore:

Në lidhje me analizen ligjore, përcaktimi i saktë i elementëve përbërës të veprës penale, ka një rëndësi themelore, pasi përbën një parakusht, që një person të merret në përgjegjësi penale e më pas, ndaj tij të zbatohet sanksioni penal. Kjo shkelje e ligjit penal material nga ana e KZAZ Nr.11, në të njëjtën kohë, përbën edhe një cenim real të se të drejtës së pronësisë që mbrohet nga Kushtetuta.

Antareve te KZAZ Nr.11 u ka perfunduar funksioni i tyre ligjor ne momentin e hyrjes ne fuqi te Dekretit te Presidentit te Republikes Nr.11199, date 10.06.2019, dhe pas kesaj date jane subjekt te vepres penale sipas parashikimit te nenit 249 te Kodit Penal qe shprehet se:

- *Vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e personit që është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.*

Per arsyet e cituara me lart, mendoj se ndodhemi perpara nje rasti te shkeljes se ligjit nga antareve te KZAZ Nr.11 – Bashkia Kukes, veprim i cili perben vepër penale te parashikuar nga dispozitat e Kodit Penal.

Pra, nga pikepamja objektive çdo veprim i ndermarre ne kundërshtim me Dekretin e Presidentit gjykohet si shkelje te legjislacionit penal.


***Për këtë arsye, nga ana e organit të prokurorisë kërkohet:***

1. Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj antareve te KZAZ Nr.11, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorim i detyrës”, të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal.

Bashkëlidhur ju lutem gjeni korespondencën e plote te cituar gjate pershkrimit te rrethanave dhe fakteve te ketij kallzimi.

*Duke shpresuar në mirekuptimin tuaj.*

**KRYETARI**  
**Bashkim SHEHU**



v.o. Bashkangjitur kallzimit penal ju dergojme:

<b>Nr.</b>	<b>Permbajtja</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1.	Dekretin e Presidentit te Republikes Nr.11199, date 10.06.2019	Flete	2
2.	Shkresa Nr.1968 Prot. date 14.06.2019- drejtuar KZAZ Nr.11	Flete	1
3.	Shkresa Nr.1968/1 Prot. date 18.06.2019- drejtuar KZAZ Nr.11	Flete	1
4.	Shkresa Nr.1997 Prot. date 18.06.2019- drejtuar Komisarariatit te Policise	Flete	1
5.	Shkresa Nr.2019 Prot. date 18.06.2019- drejtuar Sekr.Pergj.te KQZ	Flete	1
6.	E-maili i dates 10.05.2019 drejtuar Sekretarit te Pergjithshem te Prefektit	Flete	1

v.o. Bashkangjitur kallzimit penal ju dergojme:

<b>Nr.</b>	<b>Permbajtja</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1.	Dekretin e Presidentit te Republikes Nr.11199, date 10.06.2019	Flete	2
2.	Shkresa Nr.1968 Prot. date 14.06.2019- drejtuar KZAZ Nr.11	Flete	1
3.	Shkresa Nr.1968/1 Prot. date 18.06.2019- drejtuar KZAZ Nr.11	Flete	1
4.	Shkresa Nr.1997 Prot. date 18.06.2019- drejtuar Komisarariatit te Policise	Flete	1
5.	Shkresa Nr.2019 Prot. date 18.06.2019- drejtuar Sekr.Pergj.te KQZ	Flete	1
6.	E-maili i dates 10.05.2019 drejtuar Sekretarit te Pergjithshem te Prefektit	Flete	1